Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1056

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik "KROSA traffic signs" SH.P.K. të datës 27.12.2023 si dhe mbi ankesën e operatorit ekonomik OE "Sfinga" SH.P.K. të datës 27.12.2023 kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitorëve digjital ne hyrje të qytetit" me numër të prokurimit 656-23-11775-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Komuna Ferizaj", më 21/02/2024, mori këtë:

Vendim

1. **APROVOHEN si pjesërisht të bazuara** ankesat e operatorëve ekonomik "KROSA traffic signs" SH.P.K me nr. 2023/1056 e datës 27.12.2023 si dhe ankesa e operatorit ekonomik "Sfinga" SH.P.K. me nr. 2023/1057 e datës 27.12.2023 2023, kurse vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitorëve digjital ne hyrje te qytetit" me numër të prokurimit 656-23-11775-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Komuna Ferizaj", anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

"Komuna Ferizaj" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 25.10.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitorëve digjital ne hyrje te qytetit" me numër të prokurimit 656-23-11775-1-2-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për

furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 76,148.36 **€**

Me datë 08.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik "PLUS TRADE" L.L.C.; "VIZIONLEDD GROUP" SH.P.K..

Me datë 12.12.2023 operatori ekonomik ankues "KROSA traffic signs" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 18.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 27.12.2023 operatori ekonomik ankues "KROSA traffic signs" SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/1056.

Me datë 13.12.2023 operatori ekonomik ankues "Sfinga" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 18.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 27.12.2023 operatori ekonomik ankues "Sfinga" SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/1057.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues *"KROSA traffic signs" SH.P.K janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: "AK-Komuna Ferizaj, ne aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitorëve digjital ne hyrje te qytetit, , me nr. prokurimi 656-23-11775-1-2-1.*

AK nuk i ka vlerësuar ofertat konform kritereve te njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit, pasi që i njëjti AK e ka rekomanduar për kontratë OE PLUS TRADE, i Cili OE është i papërgjegjshëm pasi qe nuk e përmbush kriterin e referencave sipas nenit 69 të LPP-së, pasi që janë kërkuar referenca të ngjashme të Monitorëve Digjital, por OE i rekomanduar ka bashkangjitur ne dosje refenca të ndriçimit publik dhe montimit të trafostacioneve, e që nuk janë referenca të ngjashme siç janë kërkuar te kriteret e dosjes se tenderit dhe se OE ne fjalë ka qene dashtë të anulohet e jo të rekomandohet për kontratë. AK ne kriteret e dosjes ka kërkuar kritere të natyrës se projektit e qe OE nuk i ka përmbushur dhe se ka qene dashtë të eliminohet nga ky aktivitet. Kriteret e kërkuara te dosjes tek kapaciteti teknik dhe profesional janë".

Lidhur me kriterin e kërkuar të dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë të DT-së është kërkuar : "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlerë minimale prej 110000.00 C. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.

AK ka bere shkeljen e kritereve të FDT-se dhe NJK-se pasi qe e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i plotëson kriteret e Dosjes sipas nenit 69 të LPP-së.

Pretendimi nr.l

1. GOE PLUS TRADE LLC, VIZION LED ne listën e projekteve ka prezantuar projekte te cilat nuk janë të natyrës se ngjashme e qe nuk ka qene dashtë të rekomandohet për kontratë, por të eliminohet si OE.

Lidhur me kriterin e kërkuar të DT-së, shume qartë kërkohet qe ne rast te ofertimit si Konzorcium Lideri i Grupit duhet ti plotësoj 60^{0}/0 te referencave. Ne rastin ne fjale Kriteri i referencave është kërkuar 110,000 €, ku lideri duhet ti plotësoj se paku 60 ^{0}/0 te referencave apo 66,000.00 € e qe ne rastin ne fjale, lideri ka prezantuar ne dosjen e tij vetëm një reference te ngjashme ne Komunën e Kaçanikut me vlere 17, 799.55 € me titull: Vendosja e tabelave digjitale MIRE SE VININE KACANIK. Pra, Lideri ka qene dashtë ti plotësoj 66,000 €, kurse lideri ka prezantuar vetëm një kontratë 17,799.55 €. Pra, kjo e dëshmon se Lideri I grupit nuk e plotëson kriterin e FDT-se, pasi qe I njëjti nuk I plotëson se paku 60 ^{0}/0 te referencave. Bazuar ne kriterin e kërkuar të DT-së, ky GOE është i papërgjegjshëm pasi qe nuk e plotëson kriterin e FDT-së sipas nenit 69 të LPP-së, Lista e kontratave - Referencave. AK duhet te eliminon GOE e jo ta shpërblen me kontratë pasi qe nuk i plotëson kriteret e kërkuara dhe është i papërgjegjshëm.

Neni 59.4 i LPP-se, thotë shumë qartë se: Autoriteti kontraktues do te konsideroje nje tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi ne fjale është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Krahasimi i referencave, qe do tua prezantojmë si prove marr nga google.com. AK për këtë aktivitet ka kërkuar :

GOE I rekomanduar ka ofruar projekte të ndriçimet publik, e qe nuk janë të ngjashme, ku këtë e dëshmojmë me foto dhe shihet dallimi ne mes të ndriçimit publik dhe monitorit digjital, e qe po e paraqesim kërkimin përmes www. google.com.

SQARIM: Ana e majte Kërkesa e AK-se (te ngjashme), kurse ne anën e djathte Oferta e GOE se ka rekomanduar ndriçim publik. Poashtu edhe te kriteri Certifikata ISO 9001 2015, ju sqarojmë se: Pasi qe kriteri I DT-se ka qene: Certifikatat ISO ne emër të Operatorit Ekonomik ose grupit me te cilin konkurron . Sistemi i menaxhimit të cilësisë ISO 9001 2015. Ne rastin ne fjalë vetëm njeri nga OE e disponon këtë certifikate, dhe nuk e disponon Grupi, dhe sipas kriterit te Dosjes e bën ofertën e papërgjegjshme, e jo te rekomandohet për kontratë. Këtë me se miri e sqaron neni 26.6 i Rregullores për prokurim Publik, i cili thotë: 26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së

operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuara se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde. kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. Pra, ne rastin ne fjalë ky GOE i papërgjegjshëm e jo të rekomandohet për kontratë, pasi qe edhe vet kriteri i DT-se thotë se Certifikatat ISO duhet ti dëshmojë Operatori ose Grupi i Operatoreve, Pasi qe kriteri i DT-se ka qene: Certifikatat ISO ne emër të Operatorit Ekonomik ose grupit me te cilin konkuron Sistemi i menaxhimit të cilësisë ISO 9001 2015. Vet fjala Grupi i Operatoreve e dëshmon se këtë certifikate duhet ta plotësojnë të dy OE-të pjesëmarrës.. Kjo e bën ofertën e tij të papërgjegjshme, dhe ky GOE duhet të eliminohet e jo të rekomandohet për kontratë.

Pretendimi nr.2: Poashtu edhe GOE SFINGA& LIMIT L&B - edhe ky GOE është i papërgjegjshëm për shkak se nuk i plotëson kriteret e DT-se, për kriterin e kërkuar të FDT-së, GOE SFINGA & LIMIT L&B ne listën e projekteve ka te përfunduar vetëm një Project, të ngjashëm me vlere prej 33,333.33 Euro, me titull: Ndërtimi i mbishkrimeve digjitale ne hyrje te qytetit, me nr.prok.917-22-12863-5-2-1.

Sipas kriterit të kërkuar për liderin kërkohet qe lideri ti disponon se paku 66,000 Euro, kurse lideri ne fjalë ka ofruar vetëm projektin e lartcekur (33,333.33 Euro), qe nuk e plotëson kriterin e dosjes dhe është i papërgjegjshmen, pasi nuk ka përfunduar me shume se ketë kontratë.

Pra, GOE nuk e përmbush kriterin e kërkuar te referencave siç e potencuam me lartë. Edhe të kriteri i kërkuar Certifikata ISO, 9001-2015, ne emër të operatorit ekonomik, ose grupit me të cilën konkurron, sistemi i menaxhimit të cilësisë, ISO 9001 2015, te ky kriter I dosjes, GOE nuk është i përgjegjshëm për faktin se nuk e plotëson kriterin e kërkuar ne dosjen e tenderit për arsye se thuhet shume qarte: Te operatorit ose te grupit të Operatoreve, qe ne rastin ne fjalë, Certifikatën ISO e disponon vetëm LIMIT L&B e Cila nuk mund të vërtetohet ne link: http: eqsc-cert.org, dhe mendojmë se është certifikate e dyshimit pasi qe nuk mund te vërtetohet përmes sistemit elektronik (google.com). Poashtu partneri I grupit SFINGA nuk e disponon Certifikatën ISO 9001 2015, andaj ky GOE është i papërgjegjshëm sipas kritereve te dosjes dhe ky GOE është i papërgjegjshëm dhe duhet te eliminohet pasi qe si grup nuk disponojnë të dy OE certifikatat ISO 9001 2015.Bazuar ne nenin 59.4 te LPP-se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Neni 26.6 1 Rregullores për Prokurim Publik e sqaron shume qarte se: 26.6 Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.Pra, ne rastin ne fjalë ky GOE i papërgjegjshëm e jo të rekomandohet për kontrate. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së, pasi qe

nuk i ka plotësuar kriteret e DT-se, duke mos I trajtuar referencat sipas kriterit të kërkuar. Poashtu ka bere shkeljen e nenit 69 të LPP-së Kapaciteti Teknik dhe ose profesional dhe se ky GOE e lartcekur duhet të eliminohen për arsyet e sqaruara ne brendi të kësaj ankese. AK ka shkelur dispozitat ligjore dhe për këto shkelje ne do te detyrohemi që të vazhdojmë me tutje për zbatimin e dispozitave ligjore sipas kritereve të kërkuara te dosjes dhe njoftimit për kontratë.

Poashtu AK duke mos i trajtuar siç duhet kërkesën për rishqyrtim ka bere shkeljen e paragrafit 10.2 te nenit 108/A te LPP-se, pasi qe sipas provave te bashkangjitura AK ka qene dashtë të eliminon GOE e rekomanduar e jo të shpërblen me kontrate.Pra, AK nuk I ka trajtuar fare pretendimet tona ankimore dhe ka bere shkeljen e dispozitave ligjore, e qe këto prova ju si OSHP duhet të bëni zgjidhje konform dispozitave ligjore dhe kritereve të DT-së."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues "KROSA traffic signs" SH.P.K konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1 i LPP-së Qëllimi Neni 6 i LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtimin/Jo – Diskriminues Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 60 i LPP-së - Kriteret për dhënien e Kontratës Neni 69 i LPP-së – Kapaciteti teknik dhe profesional Neni 108A i LPP-së – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve Neni 26.6 i Rregullores për Prokurim Publik**.** Puke propozuar Aprovojë si të bazuar ankesën e OE "KROSA Traffic Signs" SHPK, dhe të anuloj Vendimin e AK-së, i cili vendim është i pa bazuar ne kriteret e DT-së, dhe përmes kësaj ankese kërkojmë qe lënda të kthehet ne Rivlerësim, dhe gjate rivlerësimit të rekomandohemi për kontratë pasi qe ne si OE jemi i përgjegjshëm, ku i plotësojmë të gjitha kriteret e kërkuara të Dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë.

***Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim**. "Autoriteti Kontraktues, Komuna e Ferizajt me datë 12.12.2023**,** ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga OE" Shpk KROSA lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitorëve digjital ne hyrje te qytetit , me Numër të prokurimit 656-23-11775-1-2-1.*

Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana juaj, ne si Autoritet Kontraktues konsiderojmë se pikat ankimore të paraqitura në kërkesat për ri-shqyrtim janë të pabazuara. Operatori Ekonomik Shpk KROSA ,i pa kënaqur ndaj Njoftimit mbi vendimin e AK ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitorëve digjital ne hyrje te qytetit , me Numër të prokurimit 656-23-11775-1-2-1., duke supozuar se janë shkelur disa nene të LPP-së .Autoriteti Kontraktues brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku konstaton si në vijim: Në lidhje me pretendimet tuaja ankimore numër 1 (një), ne si Autoritet Kontraktues ju njoftojmë se nuk kemi bere kurrfarë shkelje të LPP-se, pasi që ne bazë të ligjit referencat kërkohen me qene të ngjashëm dhe duke u bazuar edhe ne paramase për referenca përpos atyre qe janë te njëjta janë marre edhe referencat të cilat kanë të bëjë me ndriçim ne këtë raste OE i rekomandua për kontratë e marrin vlerën ashtu siç është kërkuar ne DT. Ne lidhje me pretendimin tuaj ankimor 2 (dy), ne si AK konsiderojmë se nuk kemi bere shkelje te LPP-se pasi qe Certifikata të cilën e ka ofruar ky grup I operatoreve Ekonomik ne linkun të cilën e ka të shkruar mund të verifikohet dhe

del qe është ISO 9001:2015 me validitet"

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 03.01.2024.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 03.01.2024 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "Duke pasur parasysh pretendimet ankimore ne cilësinë e ekspertit shqyrtues kam shqyrtuar dhe kontrolluar ter dokumentacionin e ofertave dhe kritereve te dosjes se tenderit dhe konstatoj se ankesa e operatorit ekonomik është e pa bazuar dhe rekomandoj PSH.OSHP që të njëjtën ta refuzoj si të pa bazuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues *"Sfinga" SH.P.K. janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: "Njoftimi lidhur me Vendimin e AK Komuna e Ferizajt e kemi pranuar me dt. 08.12.2023 me të cilin u njoftuar se jemi shpallur tenderues i pasuksesshme. Kërkuam qasje dhe ajo na u lejua. Për GOE kemi konstatuar disa mangësi .*

1. GOE e rekomanduar për kontratë nuk përmbush kriteret në bazë të kërkesave të FDT "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional Shumë qartë në FDT specifikohet : "Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë" Lideri i grupit nuk përmbush 60% të vlerës minimale . Të vetmen kontratë dhe referencë me shërbime të ngjashme të realizuar e ka me KK Kaçanik në vlerë 17799,55 euro.

2. Edhe Partneri ne GOE te rekomanduar me kontrate nuk përmbush kriteret në bazë të kërkesave të FDT "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional Ka ofruar një listë ku nuk specifikohen as datat , as vlerat e kontratave të realizuara siç kërkohet ne FDT . Poashtu nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga Partneri i GOE . Të vetmen kontratë të paraqitur nga Partneri i GOE i rekomanduar për kontratë është ajo me "HIB Petrol Corporation" SHPK e cila mban datën 26.10.2023 . Kjo kontratë e dt. 26.10.2023 është ditë e njëjtë me datën e publikimit te Njoftimit për Kontratë të këtij aktiviteti 26.10.2023 dhe nuk mund merret për baze për këtë aktivitet. Me dt.18.12.2023 ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se sa i përket kërkesës për rishqyrtim ku e ka refuzuar me arsyetimin si e pa bazuar. AK-ja ne arsyetimin e saj nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete si dhe asnjë arsyetim te bazuar se vendimi i saj paraprak ka qen i drejt dhe ne pajtueshmëri me dispozitat ligjore të LPP-së.

Gjithashtu AK-ja ne mungesë të fakteve nuk ka dhënë asnjë sqarim ne asnjë nga pretendimet tona ankimore, ku kemi dëshmuar me fakte se OE i rekomanduar për kontratë nuk e i plotëson kërkesat e FDT-se dhe dosjes se tenderit. Ne kërkesën për rishqyrtim kemi konstatuar dhe kemi argumentuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën tek Kapaciteti teknik dhe profesional pikat 9.1 dhe 9.2 ku është kërkuar që OE ekonomik të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme ne 3 vitet e fundit(duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë) ne vlere minimale 110,000.00 eurove. OE i rekomanduar për kontratë shumicën e dëshmive qe i ka prezantuar janë punime elektrike dhe ndriçime publik, por qe nuk kane lidhje me titullin e kontratës që është "Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitorëve

digjital ne hyrje të qytetit", dhe nuk janë as kontrata të natyrës se ngjashme. Duke u bazuar ne titullin e kontratës qe është i qartë që kërkon punë me "Monitor Digjital" është e qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmi qe ka punuar punë të natyrës se ngjashme, pra me furnizim, montim e vendosje të monitorëve digjital.

Ne edhe ne kërkesën për rishqyrtim e kemi sqaruar ne detaje dhe me fakte konkrete se OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e lartcekur, mirëpo AK-ja qëllimshëm po i anashkalon faktet dhe pa dhen asnjë sqarim e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim. Se AK-ja refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duhet ta arsyetoj dhe ta argumentoj vendimin e saj, e të cilën e parasheh edhe Neni 108_A i LPP-se, përkatësisht paragrafi 9 ku thotë: "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".

Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyetimet e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme, andaj të njëjtat nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh, pasi që pretendimet tona kundrejt OE të rekomanduar për kontratë janë të qëndrueshme sepse i njëjti është i papërgjegjshëm. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burime ve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa AK-ja në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita ligjore dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët".

Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim "*Autoriteti Kontraktues, Komuna e Ferizajt me datë* ***13.12.2023,*** *ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga OE* ***"****SFINGA" SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitorëve digjital ne hyrje te qytetit , me Numër të prokurimit 656-23-11775-1-2-1.Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana juaj, ne si Autoritet Kontraktues konsiderojmë se pikat ankimore të paraqitura në kërkesat për ri-shqyrtim janë të pabazuara. Operatori Ekonomik "SFINGA" SHPK i pa kënaqur ndaj Njoftimit mbi vendimin e AK ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitorëve digjital ne hyrje te qytetit , me Numër të prokurimit 656-23-11775-1-2-1., duke supozuar se janë shkelur disa nene të LPP-së .Autoriteti Kontraktues brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku konstaton si në vijim: Në lidhje me pretendimet tuaja ankimore numër 1 (një), ne si Autoritet Kontraktues ju njoftojmë se nuk kemi bere kurrfarë shkelje të LPP-së, pasi që ne bazë të ligjit referencat kërkohen me qene të ngjashme dhe duke u bazuar edhe ne paramase për referenca përpos atyre qe janë te njëjta janë marre edhe referencat te cilat kane te beje me ndriçim ne këtë raste OE I rekomandua për kontrate e marrin vlerën ashtu siç është kërkuar ne DT. "*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 03.01.2024 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 03.01.2024 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "Duke pasur parasysh shqyrtimin e pretendimit ankimore dhe dokumentacioneve të ofruara ne ofertë nga ana e Gr. të operatoreve ekonomik të rekomanduar, konstatoj se pretendimi ankimor është i pa bazuar dhe kërkoj nga ana e PSH.OSHP që të refuzoj ankesën e operatorit ekonomik si të pa bazuar."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuarme rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit tëekspertit shqyrtues me nr.1056/23 pajtohet ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues. Ndërsa lidhur me ankesën nr.1057/23 ku AK pajtohet me rekomandimine ekspertit, ndërsa OE nuk pajtohet rreth rekomandimit të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndëpa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportet e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportet e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorëve ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues *"KROSA traffic signs" SH.P.K."- Prishtinë eksperti shqyrtues në raportin e tij ka paraqitur vlerësimet dhe konstatimet si në vijim:*

Pretendimi nr.1: Gt. i OE. PLUS TRADE LLC; VIZION LED ne listën e projekteve ka prezantuar projekte te cilat nuk janë të natyrës se ngjashme e qe nuk ka qene dashtë të rekomandohet për kontrate, por të eliminohet si OE.

Përgjigja e ekspertit shqyrtues ndaj pretendimit ankimor nr.1 : Eksperti shqyrtues konstaton dhe vërteton se ne dosjen e tenderit AK ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë. Operatorët ekonomik ofertues kanë dorëzuar ofertën si grup dhe të njëjtit kanë marrëveshje të bashkëpunimit konform Nenit 71 të LPP dhe Dosjes se tenderit pikës 11.1. Lider i grupit sipas marrëveshjes se bashkëpunimit mes operatoreve ekonomik është OE ,,PLUS TRADE L.L.C" Duke pasur parasysh kërkesën e AK se OE duhet te ketë dëshmi për përfundimin e projekteve te ngjashëm ne këto koncept ne cilësinë e ekspertit shqyrtues gjatë shqyrtimit te dokumentacionit te ofertës kam hasur ne disa projekte të përfunduara nga ana e OE, liderit te

grupit ,,PLUS TRADE L.L.C" dhe të cilat ne cilësinë e eksperti konstatoj se janë te ngjashme me konceptin e prokurimit, koncepti dhe qëllimi i prokurimit ka te bëj me qështje të instalimeve elektrike, dhe operatori ekonomik përkatësisht grupi i operatoreve ekonomik ka dorëzuar dëshmitë si ne vijim e të cilat janë të ngjashme me natyrën e prokurimit:

-Kontratat dhe dëshmitë e prezantuara nga lideri i grupit ,PLUS TRADE L.L.C".

-Rregullimi i ndriçimit publik ne Komunën e Kaçanikut, Vlera e projektit 104,647.50 euro.

-Vendosja e ndriçimit publik ne territorin e Komunës se Fushë Kosovës, Vlera e projektit 47,382.00 euro.

-Rregullimi i ndriçimit publik ne Komunën e Kaçanikut, Vlera e projektit 73,555.00 euro.

-Totali i projekteve te ngjashme te prezantuara nga lideri i grupit është - 225,584.50 euro.

-Kontratat dhe dëshmitë e prezantuara nga anëtari i grupit ,,VIZIONLEDD GROUP SHPK .

-Kontrata me HIB PETROL e dëshmuar edhe me Fatura për TV DISPLAYIT ne vlerën prej, 16,300.

-FATURA për kryerjen e furnizimeve me LED DISPLAY për Armotin SHPK ne vlerën prej 15,000 euro.

- Anëtari i grupi te konzorciumit VIZIONLEDD GROUP SHPK ka ofruar si dëshmi edhe disa fatura te këtyre natyrave.

Duke pasur parasysh këto ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatoj se lideri i grupit i cili është PLUS TRADE L.L.C ka prezantuar Kontrata, dhe referenca te ngjashme ne vlerën prej 225,584.50 euro dhe i njëjti arrin 60% e kërkuar për liderin sipas kërkesës se dosjes se tenderit, po ashtu anëtari tjetër i grupit VIZIONLEDD GROUP SHPK, ka prezantuar disa Fatura dhe kontrata te natyrave të ngjashme dhe konstatoj se grupi i operatoreve ekonomik i rekomanduar për dhënie plotëson këtë kriter e referencave te ngjashme te kërkuara dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigja e Ekspertit lidhur me pretendimin ankimore për Certifikatën ISO 9001:2015, ne Dosjen e tenderit AK ka kërkuar: pasur parasysh këtë ISO standardet nuk lëshohen ne emër të grupit të operatoreve por lëshohen për operatoret, ne bazë të marrëveshjes se konzorciumit mes operatoreve ekonomik, Nenin 2 i kësaj marrëveshje përcakton se lideri i grupit është PLUS TRADE L.L.C dhe i njëjti ka prezantuar Certifikatën ISO 9001:2015 me nr.1710KS854Q.

Lidhur me këtë është edhe interpretimi i KRPP i datës 22.06.2023 nr.22 që sqaron këtë: " Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të

sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit "

Pretendimi nr.2. "Po ashtu edhe Gr. i OE SFINGA& LIMIT L&B edhe ky Gr. i OE është i papërgjegjshëm për shkak se nuk i plotëson kriteret e DT-se, për kriterin e kërkuar të FDT-së. Përgjigja e ekspertit shqyrtues: Eksperti shqyrtues konstaton dhe vërteton se ne dosjen e tenderit AK ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë. operatoret ekonomik ofertues kanë dorëzuar ofertën si grup dhe të njëjtit kanë marrëveshje të bashkëpunimit konform Nenit 71 të LPP-së dhe Dosjes se tenderit pikës 11.1.

Lider i grupit sipas marrëveshjes se bashkëpunimit mes operatoreve ekonomik është OE ,,SFINGA SHPK PRIZREN" Duke pasur parasysh kërkesën e AK se OE duhet të ketë dëshmi për përfundimin e projekteve te ngjashëm ne këto koncept ne cilësinë e ekspertit shqyrtues gjatë shqyrtimit të dokumentacionit te ofertës kam hasur ne disa projekte te përfunduara nga ana e OE, liderit te grupit "SFINGA" SHPK PRIZREN" dhe t cilat ne cilësinë e eksperti konstatoj se janë te ngjashme me konceptin e prokurimit, koncepti dhe qëllimi i prokurimit ka te bëj me qështje të instalimeve elektrike, dhe operatori ekonomik përkatësisht grupi i operatoreve ekonomik ka dorëzuar dëshmitë si ne vijim e te cilat janë të ngjashme me natyrën e prokurimit:

-Kontratat dhe dëshmitë e prezantuara nga lideri i grupit , SFINGA SHPK PRIZREN"

-Furnizim me sinjalistikë horizontale dhe vertikale - AK - NNP. Banesore Prishtinë, Vlera e projektit 21.122.00 euro.

-Sinjalizimi rrugorë dhe sistemi i unifikuar i adresave - AK - K. Suharekë, Vlera e projektit 70,787.00 euro.

-Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal - AK-K. Obiliq, Vlera e projektit 9,250.60 euro.

-Ndërtimi i mbishkrimit digjital ne hyrjen e qytetit - AK- K. Shtime, vlera e projektit 33,333.33 euro.

-Totali i projekteve te ngjashme te prezantuara nga lideri i grupit është - 134,492.93 euro referenca dhe kontrata te ngjashme sipas kërkesave të DT-së.

Duke pasur parasysh këto ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatoj se lideri i grupit i cili është SFINGA SHPK PRIZREN ka prezantuar Kontrata, dhe referenca të ngjashme ne vlerën prej 134,492.93 euro dhe i njëjti arrin 60% e kërkuar për liderin sipas kërkesës se dosjes se

tenderit, dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigja e Ekspertit lidhur me pretendimin ankimore për Certifikatën ISO 9001:2015, ne Dosjen e tenderit AK ka kërkuar: Pasur parasysh këtë ISO standardet nuk lëshohen ne emër të grupit të operatoreve por lëshohen për operatoret, ne baze të marrëveshjes se konzorciumit mes operatoreve ekonomik, Nenin 2 i kësaj marrëveshje përcakton se lideri i grupit është PLUS TRADE L.L.C dhe i njëjti ka prezantuar Certifikatën ISO 9001:2015 me nr.0199.

Lidhur me këtë është edhe interpretimi i KRPP i datës 22.06.2023 nr.22 që sqaron këtë: " Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP- së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike."

***Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues** "Sfinga SH.P.K."- eksperti shqyrtues në raportin e tij ka paraqitur vlerësimet dhe konstatimet si në vijim: "Pretendimi Ankimor nr.1: GOE te rekomanduar me kontratë nuk përmbush kriteret në bazë të kërkesave të FDT "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional, ku është kërkuar:*

Përgjigja e ekspertit shqyrtues: Eksperti shqyrtues konstaton dhe vërteton se ne dosjen e tenderit AK ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë. operatorët ekonomik ofertues kanë dorëzuar ofertën si grup dhe të njëjtit kanë marrëveshje të bashkëpunimit konform Nenit 71 të LPP-së dhe Dosjes se tenderit pikës 11.1. Lider i grupit sipas marrëveshjes se bashkëpunimit mes operatorëve ekonomik është OE ,,PLUS TRADE L.L.C"

Duke pasur parasysh kërkesën e AK se OE duhet të ketë dëshmi për përfundimin e projekteve të ngjashme ne këto koncept ne cilësinë e ekspertit shqyrtues gjatë shqyrtimit te dokumentacionit te

ofertës kam hasur ne disa projekte të përfunduara nga ana e OE, liderit te grupit ,,PLUS TRADE L.L.C" dhe të cilat ne cilësinë e eksperti konstatoj se janë të ngjashme me konceptin e prokurimit, koncepti dhe qëllimi i prokurimit ka të bëj me qështje të instalimeve elektrike, dhe operatori ekonomik përkatësisht grupi i operatoreve ekonomik ka dorëzuar dëshmitë si ne vijim e të cilat janë të ngjashme me natyrën e prokurimit:

-Kontratat dhe dëshmitë e prezantuara nga lideri i grupit ,PLUS TRADE L.L.C".

-Rregullimi i ndriçimit publik ne Komunën e Kaçanikut, Vlera e projektit 104,647.50 euro.

-Vendosja e ndriçimit publik ne territorin e Komunës se Fushë Kosovës, Vlera e projektit 47,382.00 euro.

-Rregullimi i ndriçimit publik ne Komunën e Kaçanikut, Vlera e projektit 73,555.00 euro.

-Totali i projekteve të ngjashme të prezantuara nga lideri i grupit është - 225,584.50 euro

-Kontratat dhe dëshmitë e prezantuara nga anëtari i grupit ,,VIZIONLEDD GROUP SHPK .

-Kontrata me HIB PETROL e dëshmuar edhe me Fatura për TV DISPLAYIT ne vlerën prej, 16,300 euro.

-FATURA për kryerjen e furnizimeve me LED DISPLAY për Armotin SHPK ne vleren prej 15,000 euro

-Anëtari i grupi të konzorciumit VIZIONLEDD GROUP SHPK ka ofruar si dëshmi edhe disa fatura te këtyre natyrave.

Duke pasur parasysh këto ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatoj se lideri i grupit i cili është PLUS TRADE L.L.C ka prezantuar Kontrata, dhe referenca të ngjashme ne vlerën prej 225,584.50 euro dhe i njëjti arrin 60% e kërkuar për liderin sipas kërkesës se dosjes se tenderit, po ashtu anëtari tjetër i grupit VIZIONLEDD GROUP SHPK, ka prezantuar disa Fatura dhe kontrata te natyrave të ngjashme dhe konstatoj se grupi i operatoreve ekonomik i rekomanduar për dhënie plotëson këtë kriter e referencave të ngjashme te kërkuara dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar. Vlen të theksohen se kriteri i dosjes se tenderit ka qenë çmimi me i lirë i përgjegjshëm dhe se operatorit ekonomik i rekomanduar ka çmimin me të lirë të ofertës se vlerësuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP- së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike."

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në ketë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij nuk janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë nuk e mori në konsideratë Raportet e ekspertit shqyrtues, sepse si të tilla nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe të argumentuara me prova dhe dokumente relevante.

Paneli shqyrtues administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

a) Pohimet ankimore të OE "KROSA traffic signs" SH.P.K.

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i OE të rekomanduar listën e projekteve ka prezantuar projekte te cilat nuk janë të natyrës se ngjashme e qe nuk ka qene dashtë të rekomandohet për kontrate, por të eliminohet si OE. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues ka konstatuar se lideri i grupit i cili është PLUS TRADE L.L.C ka prezantuar Kontrata, dhe referenca te ngjashme ne vlerën prej 225,584.50 euro dhe i njëjti arrin 60% e kërkuar për liderin sipas kërkesës se dosjes se tenderit, po ashtu anëtari tjetër i grupit VIZIONLEDD GROUP SHPK, ka prezantuar disa Fatura dhe kontrata te natyrave të ngjashme dhe konstatoj se grupi i operatoreve ekonomik i rekomanduar për dhënie plotëson këtë kriter e referencave te ngjashme te kërkuara dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar. Paneli shqyrtues këtë pretendim e klasifikon si pjesërisht të bazuar duke ju referuar opinionit të KRPP Nr. 11 i datës 09.06.2023, citat "*Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik*". Andaj, duke u bazuara në këtë opinion autoriteti kontraktues në këto raste mund të ju referohet kodeve të përcaktuara në FPP, pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka një sërë kontratash të përfunduara por të cilat vështirë që të kalsifikohen se cilat mund të jenë si të ngjajshme me këtë natyrë të aktivitetit të prokurimit.

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i GOE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, pasi qe edhe vet kriteri i DT-se thotë se Certifikatat ISO duhet ti dëshmojë Operatori ose Grupi i Operatoreve, Pasi qe kriteri i DT-se ka qene: Certifikatat ISO ne emër të Operatorit Ekonomik ose grupit me te cilin konkuron Sistemi i menaxhimit të cilësisë ISO 9001 2015. Vet fjala Grupi i Operatoreve e dëshmon se këtë

certifikate duhet ta plotësojnë të dy OE-të pjesëmarrës.. Kjo e bën ofertën e tij të papërgjegjshme, dhe ky GOE duhet të eliminohet e jo të rekomandohet për kontratë. Përgjigja e Ekspertit lidhur me pretendimin ankimore për Certifikatën ISO 9001:2015, ne Dosjen e tenderit AK ka kërkuar: pasur parasysh këtë ISO standardet nuk lëshohen ne emër të grupit të operatoreve por lëshohen për operatoret, ne bazë të marrëveshjes se konzorciumit mes operatoreve ekonomik, Nenin 2 i kësaj marrëveshje përcakton se lideri i grupit është PLUS TRADE L.L.C dhe i njëjti ka prezantuar Certifikatën ISO 9001:2015 me nr.1710KS854Q. Lidhur me këtë është edhe interpretimi i KRPP i datës 22.06.2023 nr.22 që sqaron këtë: "*Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit*".

Paneli shqyrtues nuk e mbështet këtë konstatim të ekspertit shqyrtues sepse eksperti shqyrtues duhet me ju referuar kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe nenit 59 të LPP vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit bëhet duke u bazuar në kërkesa të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, andaj kërkesa është se këto çertifikata kanë të bëjnë për **OE e jo për produktin**, si kërkesë e tillë parimisht nuk ka qenë dasht me u vendos nga AK sepse kjo sipas interpretimit të KRPP duhet të kërkohet kur AK ka të bëjë me kontrata për shërbime, e jo në këtë rast siç është kontrata për furnizime. Por me që kjo kërkesë është pranuar nga ana e OE dhe kanë aplikuar në tenderi dhe sipas nenit 17.7 të Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik, "*Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare*", atëherë të gjithë janë të obliguar ta pranojnë si të tillë, Kështu që, si rrjedhoj pretendimin ankimor paneli shqyrtues e kualifikon si të bazuar sepse jo të gjithë anëtarët e grupit i kanë paraqitur këtë çertifikata të cilësisë dhe duke u mbështetur në interpretimin e KRPP Nr. 29 të datës 22.06.2023, të cilin eksperti nuk e ka paraqitur si të plotë, si dhe nenin 26.6 të Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik, i cili citon: "*Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse*". Andaj, si rrjedhoj OE i cili është rekomanduar për kontratë nga ana e AK është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Ankuesi ka atakuar edhe përgjegjshmërinë e OE tjetër ankues "Sfinga" SH.P.K. i cili është i radhitur si i dyti me radhë dhe i pasuksesshëm sipas vendimit të AK, me çrast ankuesi pretendon se GOE SFINGA& LIMIT L&B - edhe ky GOE është i papërgjegjshëm për shkak se nuk i plotëson kriteret e DT-se, për kriterin e kërkuar të FDT-së, GOE SFINGA & LIMIT L&B ne listën e projekteve ka te përfunduar vetëm një Project, të ngjashëm me vlere prej 33,333.33 Euro,

me titull: Ndërtimi i mbishkrimeve digjitale ne hyrje te qytetit, me nr.prok.917-22-12863-5-2-1. Përgjigja e ekspertit shqyrtues është se Duke pasur parasysh këto ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatoj se lideri i grupit i cili është SFINGA SHPK PRIZREN ka prezantuar Kontrata, dhe referenca të ngjashme ne vlerën prej 134,492.93 euro dhe i njëjti arrin 60% e kërkuar për liderin sipas kërkesës se dosjes se tenderit, dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar. Paneli shqyrtues këtë pretendim njëjtë sikur ate më lartë e klasifikon si pjesërisht të bazuar duke ju referuar opinionit të KRPP Nr. 11 i datës 09.06.2023, citat "*Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik*". Andaj, duke u bazuara në këtë opinion autoriteti kontraktues në këto raste në fazën e ri-vlerësimit mund të ju referohet kodeve të përcaktuara në FPP, pasi që OE Sfinga SH.P.K. ka një sërë kontratash të përfunduara por të cilat vështirë që të kalsifikohen se cilat mund të jenë si të ngjajshme me këtë natyrë të aktivitetit të prokurimit.

b. Pohimet ankimnore të OE "Sfinga" SH.P.K.

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i GOE e rekomanduar për kontratë nuk përmbush kriteret në bazë të kërkesave të FDT "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional Shumë qartë në FDT specifikohet : "Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë" Lideri i grupit nuk përmbush 60% të vlerës minimale . Të vetmen kontratë dhe referencë me shërbime të ngjashme të realizuar e ka me KK Kaçanik në vlerë 17799,55 euro. Eksperti shqyrtues konstaton se duke pasur parasysh kërkesën e AK se OE duhet të ketë dëshmi për përfundimin e projekteve të ngjashme ne këto koncept ne cilësinë e ekspertit shqyrtues gjatë shqyrtimit te dokumentacionit te ofertës kam hasur ne disa projekte të përfunduara nga ana e OE, liderit te grupit „PLUS TRADE L.L.C" dhe të cilat ne cilësinë e eksperti konstatoj se janë të ngjashme me konceptin e prokurimit, koncepti dhe qëllimi i prokurimit ka të bëj me qështje të instalimeve elektrike dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar. Paneli shqyrtues këtë pretendim e klasifikon si pjesërisht të bazuar duke ju referuar opinionit të KRPP Nr. 11 i datës 09.06.2023, citat "*Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik*". Andaj, duke u bazuara në këtë opinion autoriteti kontraktues në fazën e ri-vlerësimit në këto raste mund të ju referohet kodeve të përcaktuara në FPP, pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka një sërë kontratash të përfunduara por të cilat vështirë që të kalsifikohen se cilat mund të jenë si të ngjajshme me këtë natyrë të aktivitetit të prokurimit, si dhe ka kontrata të cilat janë lidhur pasi që është bërë njoftimi për kontratë dhe eksperti shqyrtues i ka marrur si të

mirëqena, kështu që vlerësimi i ofertave të cilat janë palë me interes të bëhet konform nenit 59 të LPP.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 të LPP dhe dispozitave tjera të përmenduara në këtë arsyetim të këtij vendimi. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA FERIZAJ, KOMUNA FERIZAJ**
- OE - **" KROSA traffic signs " SH.P.K., Sfinga SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: